



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:249492
Datë: 11.10.2024
Numri i dokumentit: 06287973

C-IV.-14-5497

Ankuesi:

M H, i përfaqësuar nga **Sh H** të cilën me autorizim e përfaqëson **av. R G** nga Suhareka

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.02 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- HEDHET POSHTË si e pa pranueshme ankesa e paraqitur kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**
- Nuk caktohet taksë gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.21 korrik 2014, ankuesi parashtror ankesë kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit nr.PRZ014-0042/1421 dt.06.12.2013. Ankesës nuk ia ka bashkangjitur vendimin e atakuar të AL.

Me dt.12 korrik 2024, gjykata përmes një urdhëri i është drejtuar ankuesit duke kërkuar nga i njëjti që të bëjë dorëzimin e kopjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë. I autorizuari i ankuesit e ka pranuar urdhërin e gjykatës me dt.18 korrik 2024, por deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur gjykatës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e papranueshme.

Neni 74.2, i Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), përcakton:

Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.

Nenet 33 dhe 35, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme. Neni 35.2 më tej përcakton se çfarë duhet të përmbaj një kërkesë apo ankesë.

Neni 36.2.2.5, i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që:

*Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse:
kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 të kësaj shtojce dhe është në përputhje me dispozitat e nenit 35 të kësaj shtojce.*

Neni 36.2.2.6 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që:

*Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse:
është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa.*

Në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata vjen në përfundim se ankesa duhet të dorëzohet në gjykatë së bashku me vendimin e atakuar të Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit 30 ditor pas pranimit të vendimit. Në këtë mënyrë, dorëzimi i vendimit të atakuar nga ankuesi është një kriter i pranueshmerisë së ankesës përkatësisht mosdorëzimi i këtij vendimi nga vet ankuesi, e bën ankesën e tij të papranueshme.

Nga mbrojtja të cilën e ka pranuar gjykata ka arritur në përfundim se ankuesi nuk ka paraqitur kërkesë së pari pranë AL, ashtu që gjykata vendosi që ankesën e tij ta hedh si të papranueshme, sepse pasi që procedura pranë DHPGJS duhet të filloj kundër një vendimi të AL-së.

Për këtë në pajtim me nenet 36.1, 36.3 dhe 74.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Ankesa kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, hedhet poshtë si e papranueshme.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.23 maj 2024.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala